



Datë: 21.08.2025
Numër Protokolli: 5670/2025

A.nr.1388/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Prenaj-Zyrtare i Lartë për Inspektim Administrativ, në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas ankesës më numër A.nr.1388/2025, të datës 16.07.2025, të parashtruar nga ankuesit H.G, S.K, A.L dhe F.S sipas autorizimit të përbashkët i përfaqëson ankuesi H.G,në çështjen juridike “kompensim material”, bazuar në nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës A.nr.1388/2025, të datës 16.07.2025, të parashtruar nga ankuesit, H.G, S.K, A. L dhe F.S.

A r s y e t i m

Nëpunësit civil, H.G, S.K, A.L dhe F.S, (tutje referuar: ankuesit), më datë 16.07.2025 përmes përfaqësuesit të autorizuar Haradin Gërvalla, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të organit të punësimit në raport me kërkesën e datës 22.05.2025, për anulimin e Vendimit me numër protokolli 3514, të datës 19.12.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, si dhe Vendimet për Zyrtarët e liruar nga detyrat si ushtrues detyre si dhe kompensimin retroaktiv.

Më datë 19.08.2025, ankuesit përmes përfaqësuesit me autorizim kanë parashtruar kërkesë përmes postës elektronike ankesa.kpmshck@rks-gov.net, për tërheqjen e ankesës së datës 16.07.2025, duke mos specifikuar arsyet e tërheqjes së ankesës.

Kolegji i Këshillit duke marr për bazë kërkesën e datës 19.08.2025 për tërheqje nga ankesa e datës 16.07.2025, konstatoi plotësimin e kushtit ligjor për përfundimin e procedimit administrativ, siç parashihet me dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”, dhe si rrjedhojë në mbështetje të nenit 18, paragrafit 1, nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për përfundimin e procedimit administrative të filluar sipas ankesës A.nr.1883/2025, të datës 16.07.2025.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1388/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Malsore Gashi Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve: H.G;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të KPMM-së; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së